

PËRSHËNDETJE NGA PATRICE DE MESTRAL


THEMELUES DHE KOORDINATOR I PROJEKTIT “KAPE TË ARDHMEN”

Kujt mund t'i shkonte nëpër mend se projekti “Kape të Ardhmen” do të vinte deri në ditën e sotme?

Është me të vërtetë një histori e mbushur me sukses, por le të mos harrojmë që, pa punën e zellshme dhe plot durim të një grupi të kualifikuar punonjësesh sociale, të udhëhequr nga një

drejtuese shumë kompetente, Irena Dono Jorgaqi, projekti ynë do të ishte shuar me kohë...

Në një letër të kohëve të fundit, të dërguar më datë 2 Mars 2004 Ministria e Punëve të Jashtme të Zvicrës, Madam Micheline Calmy-Rey shkruante se ajo ishte shumë krenare që grupi i suksesshëm i Kape-s përbëhet kryesisht nga gra. Është meritë e tyre që zhvilluan një projekt për një target grup nga më të vështirët, të rinjtë shqiptarë të riatdhesuar, të cilët kishin lënë atdheun e tyre nga varfëria, me shpresën për të gjetur një jetë më të mirë diku gjatë në Evropë.



Kur kthej vështrimin pas në fillimet e projektit, i cili nisi në Prill 1999, në mes të luftës së Kosovës, më vjen ndër mend që pas gjashtë muajsh ne thuajse u përgatitëm ta ndërprisnim këtë projekt, sepse pak të rinj të riatdhesuar na kishin ardhur në zyrë. Madje edhe ata me një mosbesim të

madh, që një organizëm zviceran mund të kishte vullnetin e mirë për t'i ndihmuar të nisnin një jetë të re në Shqipëri, pasi ishin riatdhesuar nga policia zvicerane.

Sot Projekti “Kape të Ardhmen”, që është një projekt i shoqatës shqiptare “Shpresë për të Ardhmen” është i njohur si në Shqipëri ashtu edhe në Zvicër. Si themelues dhe koordinator i saj, unë shpresoj shumë që Shpresë për të Ardhmen të jetë e aftë të “shqipërojë” këtë dhe projekte të tjera, duke u treguar kështu shqiptarëve se është diçka me vlerë të zhvillosh projekte, të cilat nuk kanë vetëm qëllime materiale, por qëllime dhe vizione më të gjëra për të ardhmen e një Shqipërie të begatë dhe normale.

Me rastin e pesëvjetorit të krijimit, do të dëshiroja të falenderoja të gjithë donatorët e panumërt, të cilët dhanë ndihmesën e tyre që në fillësë dhe në rrjedhën e viteve.

Do të përmendja këtu veçanërisht Agjencinë Zvicerane të Kishave Protestante, HEKS, dhe personin përgjegjës Madeleine Hirsch, SDC (Agjencia Zvicerane e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit) në Tiranë dhe Bernë, EED (Agjencia për Zhvillim e Kishës Evangjelite Gjermane) dhe IOM Londër dhe IOM Tirana, të cilat kanë garantuar mbështetjen e tyre deri në fund të vitit 2004.

Ne shpresojmë shumë se të gjithë

donatorët në Zvicër, Gjermani dhe Angli do të vazhdojnë ta mbështesin këtë projekt të pazakontë, që nisi si një iniciativë private e si rrjedhojë e përvojës së mundimshme të një kapelani burgu në Zvicër, i cili e kuptoi se të rinjtë shqiptarë kishin nevojë për një perspektivë për të krijuar një të ardhme, pas kthimit forcërisht nga Evropa në Shqipëri.

Dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishmja, unë do të falenderoja të gjithë të rinjtë e përfshirë në këtë projekt, që fituan besimin në vetvete, por gjithashtu edhe pronarët e bizneseve të vogla, të cilët patën mirësinë t'u jepnin këtyre të rinjve shqiptarë një shans për një fillim të ri në atdheun e tyre.

**PROJEKTI "KAPE TË ARDHMEN" QË NJË KRIJESË E
ADHURUAR PREJ KRIJUESIT TË VET, PATRICE DE MESTRAL.
STAFI U MUNDUA TA RRISTE KËTË KRIJESË TË ADHURUAR
ME KUJDESIN DHE PËRKUSHTIMIN E NJË PRINDI
TË MIRË PËR FËMIJËN E VET.**

**FOSH NJA TANI ËSHTË BËRË PESËVJEÇARE DHE
MUND TË FLASË VETË...**

I. Dono

SHOQATA “SHPRESE PËR TË ARDHMEN”

dhe PROJEKTI “KAPE TË ARDHMEN”

- KTHIM NË RETROSPEKTIVË -

EMIGRIMI

“Në Zyrih qëndruam rreth gjashtë muaj. Gjatë gjithë kësaj periudhe kërkonim punë, por ishte e pamundur. Dita-ditës shpresa për punë vinte duke u venitur dhe gjendja financiare ishte shumë e dobët. Zhgënjimi shumë i madh dhe papunësia më detyruan të kthehesha përsëri në Shqipëri, por me xhepat bosh...”

E njëjta histori është përsëritur për qindra shqiptarë, të cilët kanë emigruar në Zvicër. Emigrimi është një nga problemet sociale më të mëdha që ka hasur shoqëria shqiptare gjatë dhjetë viteve të fundit. Rritja e papunësisë, niveli i ulët i jetesës si dhe një sërë vështirësish jetike i detyruan të rinjtë shqiptarë të sakrifikonin ngrohtësinë familjare, miqësinë, dashurinë në kërkim të një jete më të mirë larg Shqipërisë. Një prej shteteve që nxiti dhe zgjoi kureshtjen shqiptare për “jetë përrallore dhe pasurim të shpejtë” ishte Zvicra. Ajo ishte një nga vendet më të favorshme për emigrim për arsye të nivelit të lartë të jetesës dhe kushteve të mira që u ofronte emigrantëve.

Shumë të rinj shqiptarë e shihnin dhe madje vazhdojnë ta shohin Zvicrën si një parajsë ku mund të bëhet fare lehtë parë e madhe duke shpërndarë drogë dhe duke bërë veprime të tjera të paligjshme. Pjesa dërrmuese e këtyre njerëzve bëhen kontigjent i burgjeve dhe dëbohen nga Zvicra, duke humbur të drejtën të rihyjnë aty për disa vjet apo përgjithnjë.

Disa shifra për shqiptarët e riatdhesuar, të kthyer nga autoritetet zvicerane pesë vitet e fundit

Këto shifra nuk janë të deklaruara zyrtarisht në publik, pasi nuk ekziston një praktikë e tillë në Zvicër dhe si rregull nuk mund t'i jepen publikut. Por këtu jepen shifra të përafërta, të cilat korrespondojnë me informacionet e marra nga Patrice de Mestral në policinë kufitare dhe në aeroportin e Klotenit. Këto shifra përfshijnë riatdhesimin e shqiptarëve nga të gjitha kantonet e Zvicrës, të zbatuara nga policia kufitare në Kloten. Ato nuk përputhen plotësisht me shifrat e ZFR (Zyra Federale për Refugjatët) në Bernë, e cila ka një sistem tjetër përlllogaritjeje ku hyjnë edhe të kthyerit vullnetarisht,

por në tërësi shifrat nga 1998-2001 mund të merren si të sakta. Nga 2002 e më tej informacioni i marrë bazohet kryesisht në vizitat periodike të Z. de Mestral në zyrat përkatëse, por ai është informuar jo zyrtarisht nga autoritetet.

PROJEKTI “KAPE TË ARDHMEN”

“Kape të Ardhmen” është projekt i shoqatës jofitimprurëse “Shpresë për të

Viti	Persona të kthyer / në vit	Në muaj rreth
1998	2543	212
1999	1613	134
2000	1100	82
2001	830	69
2002	415	35
2003	216	17

KTHIMI

Të rinjtë shqiptarë, të zhgënjyer më shumë se kurrë, i detyruan të kthehen në Shqipëri. Realiteti vërtetoi edhe këtë herë faktin se ëndrrat mbeten larg të vërtetës. Të kthyerit e panë veten në udhëkryq të jetës, të dëbuar nga shteti i huaj dhe të braktisur nga shteti i tyre. Por dikush duhej t'i ndihmonte këta njerëz të vuajtur që kishin nevojë për përkrahje, dikush duhej t'i dëgjonte hallet e tyre, t'u zgjaste dorën dhe të rizgjonte tek ata besimin në vetvete dhe në forcën njerëzore.

Projekti “Kape të Ardhmen” lindi pikërisht si një nevojë dhe domosdoshmëri për t'u ardhur në ndihmë kësaj kategorie njerëzish për të rigjetur veten në vendin e tyre.

Ardhmen”. Fillimet i përkasin nëntorit të vitit 1998 kur me iniciativën e Dr. Patrice de Mestral, një kapelan burgu që kishte pasur kontakte të shumta me të rinjtë shqiptarë të penalizuar në Zvicër, u bë e mundur që ky projekt të mos ngelej vetëm një ide e autorit, por të zhvillohej në Shqipëri. Bashkë me z. de Mestral në këtë sipërmarrje të vështirë u gjend edhe punonjësja sociale zvicerane Franciska Camenzind, e cila luajti një rol të rëndësishëm në fazën e parë të projektit për rekrutimin dhe trajnimin e stafit si edhe për të hedhur piketat e para të projektit. Ishte një projekt pilot që kishte këta objektiva kryesorë: riintegrimin e të riatdhesuarve nga Zvicra në shoqërinë shqiptare; zhvillimin e aftësive të reja arsimore dhe profesionale, në mënyrë që t'i ndihmonte të rinjtë të gjenin dhe të zbulonin mundësi të reja jetese në vendin e tyre;

krijimin e mundësive të reja të punësimit për shqiptarët e riatdhesuar si dhe të ndihmonte shqiptarët të rizbulonin krenarinë e të qenit shqiptar duke marrë pjesë aktive në zhvillimin e të ardhmes së tyre në Shqipëri. Puna filloi me rekrutimin e personave të kthyer nga Zvicra dhe për këtë shërbeu edhe investigimi njëmuor pranë aeroportit të Rinasit për shqiptarët e riatdhesuar që filloi me shpërndarjen e një pyetësoi dhe shpjegimin e qëllimit të projektit. Kërkesat e pyetësorit kishin të bënin me moshën, nivelin arsimor, arsyet e largimit nga Shqipëria, identifikimin e nevojave dhe dëshirave të të rinjve etj., në mënyrë që të përcaktoheshin shërbimet më efikase që do t'i ofroheshin këtij target grupi. Informacion shtesë u kërkuar edhe në Zvicër.

Në muajin Prill 1999 u hap në Tiranë Zyra e Informacionit, Këshillimit dhe Mbështetjes për të zbatuar projektin.

Në nëntor 1999 OJQ-ja u legalizua nga Gjykata e Tiranës me emrin Shpresë për të Ardhmen.

SHËRBIMET E PARA

Puna nisi me mbledhjen e informacionit për:

- Kurse të kualifikimit profesional
- Kurse trajnimi, si kurse të gjuhëve të huaja, kompjuteri etj.
- Shoqata që ofronin shërbime sociale.

Mbledhja e këtij informacioni u bë duke patur kontakte direkte me këto institucione si dhe me përfaqësuesit e tyre. Gjithashtu

stafi i projektit hartoi një fletëpalosje, e cila u shpërnda në Zvicër, Tiranë dhe në disa rrethe të Shqipërisë dhe mundësoi ardhjen e të rinjve të parë në zyrë. Gjatë muajve Prill-Tetor 1999 zyra u ofroi shqiptarëve të riatdhesuar informacion për vende pune dhe kurse trajnimi, këshillim për probleme personale dhe familjare si dhe krijoi disa miniprojekte punësimi. Periudha prill-gusht 1999 ishte një periudhë jo shumë intensive pune sepse, përveç informacionit, mundësitë konkrete që u ofroheshin klientëve ishin të pakta. Gjatë periudhës emergjente të luftës në Kosovë, zyra ofroi shërbime afatshkurtra punësimi për kosovarët në Tiranë nëpërmjet miniprojektit “Lulet zbukurojnë mjedisin”. Projekti u realizua në muajin Qershor dhe ofroi mbështetje për refugjatët kosovarë, të cilët u përzgjedhën nga kampi i refugjatëve në bazë të disa kriterëve që u vendosën nga punonjëset sociale të zyrës. Punimet u ndërmorën në zonën përpara pallatit ku ndodhej zyra e shoqatës.

Megjithë vështirësitë e hasura, ky miniprojekt u konsiderua i suksesshëm. Vetë refugjatët kosovarë u shprehën se ishin shumë të kënaqur që iu dha mundësia të punonin pasi, përveç mbështetjes financiare, puna i ndihmoi të largonin stresin dhe tmerret e luftës. Shërbimet e pakta që iu ofruan në fillim shqiptarëve të riatdhesuar më pas u konsideruan të pamjaftueshme dhe jo shumë të frytshme dhe kështu lindi nevoja për ndryshime.

SHËRBIME NË VAZHDIM

Që prej Tetorit 1999 e në vazhdim Shoqata "Shpresë për të Ardhmen" nëpërmjet Projektit "Kape të Ardhmen" u ka ofruar klientëve një periudhë 9-mujore mësimi profesioni pranë punishteve të vogla apo bizneseve të tjera më të mëdha. Kjo realizohet me firmosjen e një kontrate midis përfaqësuesit të zyrës dhe biznesmenit me kushte të pranuar nga të dyja palët. Projekti merr përsipër të paguajë 60% të pagës të të riut që merr një profesion. Qysh nga ajo kohë projekti ka krijuar gjithashtu mbështetje të plotë financiare për kurse të ndryshme trajnimi.

TAKIMET "SHTËPIA E HAPUR"

Takimet e quajtura "Shtëpia e Hapur" janë një ndër aktivitetet sociale periodike të projektit. Ky aktivitet është një mundësi e mirë për të rinjtë që të bashkohen me njëri-tjetrin dhe të bëjnë biseda të hapura dhe të çiltra ku shkëmbehen eksperiencat e jetës, diskutohet për problemet, shqetësimet aktuale dhe planet që kanë për të ardhmen. Të rinjve u kërkohet të japin ide dhe mendime racionale për zhvillimin e projektit që mund t'i vlejnjë stafit për të ardhmen. Duke pasur kontakte të vazhdueshme me të rinjtë, stafi ynë është më pranë nevojave dhe problemeve të tyre. Ky fakt ndihmon të realizohet një vlerësim i saktë i situatës



Përfituesi i parë i projektit.

ku ndodhemi si edhe të përcaktohen hapat që do të ndërmerren në vazhdim.

Takimet "Shtëpia e Hapur" nuk organizohen vetëm në Tiranë, por edhe në rrethet ku ne kemi një numër të konsiderueshëm përfituesish. Të gjitha këto kryhen në kuadrin e zhvillimit të një pune komunitare.



Nga takimet "Shtëpia e Hapur".



Nga takimet "Shtëpia e Hapur".

VITI 2000

Në krahasim me vitin 1999, viti 2000 shënon ndryshime të dukshme në projekt. Gjatë periudhës së vitit 2000 në zyrë u paraqitën 185 të rinj të riadhesuar, nga të cilët 173 ishin meshkuj dhe 12 femra. Siç shihet qartë, në krahasim me vitin parardhës, është rritur në mënyrë të ndjeshme numri i klientëve të të dyja seksëve.

Një specifikë tjetër që bie në sy ishte dhe rritja e numrit të klientëve që kanë migruar nga zonat rurale ose qytetet e vogla drejt zonave të mëdha urbane. Duke marrë parasysh vështirësitë e integritimit me jetën e kryeqytetit, këtij target grupi iu kushtua më tepër vëmendje nga ana e stafit të projektit, pasi dhe nevojat e tyre ishin më të mëdha. Një nga drejtimet e tjera me të cilin vazhdoi të punohej ka qenë edhe kontakti me të rinjtë e kthyer nga Zvicra në aeroportin e Rinasit. Vijueshmëria e këtyre

kontakteve mundësoi përhapjen e informacionit jo vetëm te të rinjtë e riadhesuar, por edhe te subjekte të tjera të interesuara (njerëz të ndryshëm apo punonjës policie etj.).

Një moment tjetër që duhet përmendur gjatë kësaj periudhe, është edhe ai i përpjekjeve për të hyrë në një rrjet bashkëpunimi me organizmat e tjerë qeveritare dhe joqeveritare që operonin në

fushën e emigracionit. Këto përpjekje shpesh ishin efikase dhe ndihmuan në pasurim dhe rifreskim të informacionit që zotëronte zyra për shërbimet që u ofrohen personave të riadhesuar nga shtete të ndryshme të Evropës. Si rezultat i punës së bërë lindi dhe u vu në zbatim koncepti "Historia e Emigrimit". Secilit prej të rinjve që paraqitet në zyrën tonë ne i kërkojmë të shkruajë historinë e emigrimit. Mes shumë historive të shkruara lexon heshtur vuajtjet dhe dramën e emigrantëve shqiptarë, bëhesh më i ndërgjegjshëm për shkaqet dhe pasojat e migrimit ilegal. Në fund të çdo viti jepet një çmim për historinë të mirë nga stafi i shoqatës.

Të gjitha historitë e mbledhura ndihmuan në krijimin e një dosjeje të veçantë dhe presin të shohin së shpejti dritën e botimit.

VIZITA

Në qershor të vitit 2000 erdhën për të vizituar projektin një grup zviceran prej

10 vetësh, i udhëhequr nga koordinatori i projektit Z. Patrice De Mestral. Ata vizituan zyrën dhe patën takime me të rinjtë përfitues dhe trajnuesit e tyre në Tiranë, Durrës, Berat, Fier etj. Ata u njohën më nga afër me problemet që has në përgjithësi biznesi shqiptar, por edhe me vështirësitë e të rinjve që shpesh kanë të bëjnë që me gjetjen e vendit

të punës, përshtatjen me kushtet e reja të punës dhe jetës në përgjithësi pas riatdhesimit.

Qëllimi kryesor i kësaj vizite, e para e këtij lloji për ne, ishte njohja më nga afër e realitetit shqiptar si dhe e mënyrës së zbatimit të projektit në vendin tonë. Duhet theksuar se përshtypjet e tyre për punën që realizohej nga stafi i projektit ishin mjaft pozitive. Ata e konsideruan këtë projekt si frytdhënës dhe të domosdoshëm për riintegrimin e të rinjve të riatdhesuar nga Zvicra.

VITI 2001

Viti 2001 ka qenë një periudhë e konsolidimit të aktivitetit të projektit “Kape të Ardhmen”. U kapërcyen vështirësitë e fillimit të punës, të cilat bënin që zhvillimet e projektit të ecnin ngadalë, me ritëm të ulët dhe pa përfituesit që priteshin të kërkonin shërbimet e zyrës.



Vizita e grupit zviceran

Periudha Janar-Dhjetor 2001, sidomos muajt Janar-Maj, ka qenë për zyrën tonë një periudhë pune intensive me një fluks të madh të rinjsh të kthyer nga Zvicra, të cilët kërkuan të përfitonin nga shërbimet e projektit. Në këtë vit kanë aplikuar në zyrën tonë 258 të rinj, 233 meshkuj dhe 25 femra. Siç shihet, pjesa më e madhe janë meshkuj, por, në krahasim me dy vitet e para, numri i femrave që janë paraqitur te ne është në rritje. Projekti u ka dhënë përparësi femrave, të cilave u është ofruar menjëherë mundësia për të përfituar nga programi.



Silvana



Aldona

Pjesa më e madhe i përkasin të rinjve që kanë ardhur nga veriu i Shqipërisë dhe janë vendosur në Tiranë, ndërsa pjesa tjetër janë të rinj nga Berati, Shkodra, Fieri, Durrësi etj.

Projekti është munduar t'i ruajë e konsolidojë shërbimet në disa zona të Shqipërisë si në rrethet Berat, Shkodër, Tiranë ku ekziston një kontigjent i madh të rinjsh të kthyer nga Zvicra, por ai nuk ka rreshtur së ndihmuari edhe të rinj të rretheve të tjera si Elbasan, Lezhë, Librazhd, Shkodër etj. Gjatë vitit 2001 janë nënshkruar 133 kontrata për vazhdimin e kursit 9-mujor të kualifikimit për profesione të ndryshme si p.sh. punëtorë në punishte duralumini, mekanikë, xhenerikë, kuzhinierë, etj.

Interesi për kurset e trajnimit si kurse kompjuteri, gjuhësh të huaja etj. ka qenë më i pakët. Megjithëse ne u munduam t'i nxisnim të rinjtë të kryejnë kurse të tilla, atyre u mungon dëshira. Mendojmë se ky fakt justifikohet me arsyen e thjeshtë të situatës aktuale në Shqipëri. Shumica e tyre jetojnë në kushte të vështira dhe kanë një nivel të ulët ekonomik. Në këto rrethana, ata janë më tepër të interesuar të mësojnë

një zanat dhe të fitojnë ca para, sesa të kryejnë një kurs kompjuteri apo anglishteje. Pra, marrja e një zanati është më pranë nevojave të tyre.

REZULTATE TË VITIT 2001

Rezultatet e punës së vitit 2001 kanë qënë mjaft pozitive. Ato maten jo vetëm me numrin e klientëve të regjistruar në zyrë apo numrin e kontratave të realizuara, por edhe me qëndrimin në punë ose jo të klientëve pas periudhës 9-mujore të trajnimit profesional si edhe me vlerësimin që i bëjnë të rinjtë e përfshirë në program projektit tonë. Pas përfundimit të periudhës 9-mujore gjatë vitit 2001 mund të themi se afro 80% e të rinjve vazhduan të punonin në të njëjtat vende pune. Gjithashtu konkluzionet e nxjerra nga pyetësorët e përgatitur për këtë qëllim na bëjnë të ditur se të gjithë të rinjtë e vlerësojnë kursin 9-mujor si shumë të dobishëm dhe shërbimin e zyrës shumë të mirë.

PUBLICITETI

Gjatë vitit 2001 u bë një punë e madhe përsa i përket publicitetit rreth aktivitetit të projektit "Kape të Ardhmen". Përveç shpërndarjes së fletëpalosjeve kudo në Shqipëri, publicitet u realizua edhe nëpërmjet medias elektronike dhe të shkruar. U botuan disa artikuj rreth projektit "Kape të Ardhmen" si edhe u realizuan disa intervista

me drejtuesen e projektit në disa gazeta kryesore shqiptare. Diçka me vlerë u quajt realizimi dhe shfaqja e filmit dokumentar “Kape të Ardhmen”. Ky film u realizua nën regjinë e regjisorit të mirënjohur të radiotelevizionit Publik Shqiptar, Ylli Pepo dhe shfaqja e tij u bë e mundur në muajin Shkurt 2001. Filmi u transmetua në TVSH si edhe jashtë Shqipërisë në rrugë satelitore. Filmi dokumentar “Kape të Ardhmen” jep një panoramë reale të emigrimit në Zvicër dhe të aktivitetit të shoqatës sonë. Ky aktivitet shërbeu si një mundësi e mirë për të bashkuar disa organizata qeveritare dhe joqeveritare që merren me migrimin si edhe ndihmoi në rritjen e numrit të klientëve. Atë vit dhe në vazhdim disa gazetarë zviceranë kanë vizituar shoqatën tonë dhe kanë botuar artikuj në gazetat zvicerane për programin tonë të riintegrit.

Realizuesit e filmit me klientët tanë.



AKTIVITETE TË TJERA NË 2001

Viti 2001 shënoi diçka të re për projektin. Kjo ka të bëjë jo vetëm me fluksin e madh të klientëve të ardhur në zyrë, por edhe me iniciativat dhe drejtimit e reja që mori projekti. Bordi i shoqatës së bashku me koordinatorin e projektit vendosën të vinin në jetë një ide tashmë shumë herë të diskutuar nëpër takimet e përbashkëta: mbështetje për të rinjtë edhe pas periudhës 9-mujore të formimit profesional. Më konkretisht u mbështetën financiarisht katër grupe të rinjsh që të hapnin një biznes të vogël. Qëllimi ishte që të ndihmoheshin këta të rinj të zhvillonin biznesin e vogël vetiak, duke i hapur kështu rrugë iniciativës së tyre të lirë dhe për t'i pasur këto biznese të vogla si qendra trajnimi për të rinj të tjerë të projektit. Stafi i projektit synonte gjithashtu të kultivonte tek ata dëshirën për të qëndruar përgjithnjë në Shqipëri, duke i shërbyer kështu në të njëjtën kohë interesit vetiak dhe interesit të vendit të tyre. Stafi i zyrës, duke qenë i ndërgjegjshëm për problematikën dhe riskun që shfaq dhënia e huasë, ka treguar kujdes në përzgjedhjen e klientëve që do të përfitonin këtë shërbim. Zyra ndoqi hap pas hapi ecurinë e bizneseve dhe vuri re se të rinjtë iu përkushtuan punës me të gjitha forcat, duke punuar me orar të zgjatur. Por, për arsye më shumë objektive se subjektive 3 prej grupeve të klientëve tanë e ndërprejnë biznesin e hapur, ndërkohë që shlyen vetëm një pjesë të vogël të detyrimit

financiar që kishin ndaj zyrës së projektit. Arsyet e ndërprerjes së aktivitetit erdhën si rrjedhojë e situatës së rëndë në vend ku vlen të përmendet gjendja energjitike shumë e rënduar dhe taksat e larta si edhe konkurenca e madhe. Grupi i parë, i cili përbëhet nga katër ish-klientë të Kapes, arriti që në sajë të vullnetit dhe punës së bërë të kapërcente një sërë pengesash dhe të mbijetonte. Mobileria e pagëzuar prej tyre “Kape të Ardhmen” vazhdon të punojë dhe të jetë e suksesshme.

Në vazhdim të një pune kërkuese shoqata “Shpresë për të Ardhmen” në Mars 2001 nxori në qarkullim botimin e saj të parë, i cili titullohet “Shpresë”. Ky botim i përgatitur nga drejtuesja e projektit pasqyron gjerësisht aktivitetin e shoqatës dhe ka një material të pasur faktik.

VIZITA

Në shtator 2001 një grup tjetër zviceran vizitoi Shqipërinë për të parë nga afër punën e shoqatës sonë. Grupi përbëhej nga persona të cilët e njihnin problemin shqiptar të migrimit. Pjesa më e madhe e tyre ishin punonjës në burgjet e Zvicrës si p.sh. punonjës socialë, edukatorë burgu, punonjës policie, të cilët kishin kontakte të drejtpërdrejta më të rinjtë shqiptarë në Zvicër. Mes tyre ndodheshin edhe tre studente të sapodiplomuara në Shkencat Sociale, që kishin mbrojtur diplomën me temë “Kape të Ardhmen”.



Takim me klientët në Shkodër



Vizitë në Berat

Grupi zviceran vizitoi qytetet e Beratit, Shkodrës, Lezhës, Fierit, Krujës, Tiranës ku u njoh nga afër me klientët tanë dhe punën e tyre. Ata e vlerësuan shumë punën e bërë nga stafi ynë dhe dhanë sugjerimet e tyre për të ardhmen. Më i rëndësishmi ishte se kishte ardhur koha që Kape të Ardhmen tashmë të institucionalizohej.

VITI 2002

Shoqata dhe projekti tashmë ishin konsoliduar, por sërish ndihej nevoja për ndryshime dhe arritje të reja. Eksperienca e viteve të mëparshme kish treguar arritje reale të objektivave të vendosura si edhe rritje të konsiderueshme të numrit të klientëve. Në këto kushte dëshira dhe mundësia për të punuar me këtë target grup ngelej e fortë, por stafi i projektit, i mbështetur edhe nga anëtarët e bordit të shoqatës mendoi se ishte koha për të ecur edhe më në drejtim të përmirësimit dhe progresit. Në këtë kuadër ne realizuam disa takime me organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare duke pasur si qëllim kryesor bashkëpunimin në të ardhmen si p.sh. Shërbimi Social Ndërkombëtar, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Qendra Rinore Sociale Tiranë, IOM Tiranë etj.

Shoqata jonë në bashkëpunim me Shoqatën “RIART” duke pasur si objektiv të përbashkët të sjellin në fokusin publik shqiptar problemin e të rinjve që nuk e shohin të ardhmen e tyre në Shqipëri, por duke migruar në vende të tjera, mundësuan hartimin dhe botimin e broshurës “VIRUS”. Shoqata “RIART” ishte një shoqatë e re ku ishin anëtarësuar të rinj që vinin nga fusha të ndryshme të artit. Qëllimi i këtyre të rinjve ishte që me anë të punëve të tyre artistike t’i shërbenin shoqërisë shqiptare duke evidentuar dhe luftuar problemet e shumta sociale, të cilat e kanë kërcënuar këtë shoqëri përgjatë viteve të tranzicionit. Libërthi me ilustrime, “Virus” prodhim i Shoqatës “RIART”, sponsorizuar nga Shoqata “Shpresë për të Ardhmen” u shpërnda falas midis gjimnazistëve të tre shkollave, përkatësisht “Sami Frashëri” Tiranë, “Kristaq Capo” dhe “Babë

Nr.	Moshë				Mendimi juaj për emigracionin			Keni emigruar ndonjëherë?		N.q.se do t'ju jepej mundësia për emigrim		Mendon se familja do t'ju mbështeste?		Midis dy alternativave të dhëna, cila do të ishte zgjidhja juaj?		
	15	16	17	18	Poz.	Neg.	Poz. & Neg.	Po	Jo	Po, do ta bëja	Jo, do ngurroja	Po	Jo	Emigrim në vend të huaj	Shkollim në Shqipëri	
F	165	36	65	38	26	28	118	19	11	154	73	92	71	94	24	141
M	95	14	40	31	10	31	60	4	21	74	48	47	32	63	14	81
Σ	260	50	105	69	36	59	178	23	32	228	121	139	103	157	38	222
%	100	19	41	26	14	23	68	9	12.3	87.7	46.5	53.5	39.6	60.4	14.6	85.4

Dudë Karbunara” Berat. Libërthi ishte krijuar në mënyrë të tillë ku nëpërmjet ilustrimeve dhe bisedave të zhvilluara midis personazheve synohej në ndërgjegjësimin për rreziqet dhe të papriturat që vijnë nga emigrimi në përgjithësi dhe më konkretisht migrimi ilegal në Zvicër. Shpërndarja e tij u organizua në formën e një bisede të hapur me të rinjtë ku u fol për shumë aspekte të emigracionit, për eksperiencat e mundshme qoftë personale apo dhe familjare e shoqërore. Në faqen e fundit të libërthit u vendos një pyetësor për të parë opinionin e të rinjve mbi emigracionin, politikave të shtetit tonë në lidhje me këtë fenomen dhe zgjedhjeve të tyre në të ardhmen. Vlen të përmendet fakti që shumë nga të rinjtë e shihnin emigracionin si një gjë sekondare aspak si domosdoshmëri, përkundrazi thelbësore për ta ishte shkollimi apo marrja e një profesioni. Ky aktivitet është bërë tashmë pjesë e


programit të shoqatës dhe organizohet në shkolla të ndryshme të vendit, me qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve për rreziqet dhe problemet e migrimit ilegal.

TAKIM ME BIZNESMENË

Një tjetër aktivitet i rëndësishëm i zhvilluar gjatë vitit 2001 ishin takimet e realizuara me biznesmenët e vegjël, me të cilët ne bashkëpunojmë për të realizuar programin tonë të riintegritit profesional. Qëllimi i organizimit të këtyre takimeve ishte identifikimi i nevojave, problemeve dhe interesave të tyre në planin profesional. Gjithashtu u kërkua prej zyrës dhënia e ideve, sugjerimeve për bashkëpunimin me ta në të ardhmen. Gjatë takimeve u diskutua gjatë për vështirësitë që hasin biznesmenët në ushtrimin e aktivitetit të tyre privat si dhe për mënyrat e një bashkëpunimi më efikas me zyrën tonë. U hodhën shumë ide,

Faktori më i rëndësishëm në zvogëlimin e emigracionit sipas mendimit tuaj është:			Progresi i Shqipërisë do jetë i lidhur me emigracionin?	
Rritja e nivelit ekon.	Lufta ndaj emigrac. ilegal.	Liberalizimi i politikave të emigr.	Po	Jo
147	13	5	107	58
85	5	5	63	32
232	18	10	170	90
89.2	7	3.8	65.4	34.6

SHTETET MË TË PREFERUARA





të cilat shërbyen për të përcaktuar format e bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke për të ardhmen.

PJESËMARRJE NË PANAIR

Pjesëmarrja në Panairin e Të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës, organizuar nga PARSH dhe CIVET nga datat 21-24 Tetor 2002 ishte e rëndësishme për shoqatën tonë. Ishte përvoja jonë e parë në këtë lloj aktiviteti që na solli kënaqësi dhe ishte një formë e mirë publiciteti. Vizitorët ishin mjaft të interesuar të mësonin për aktivitetin e shoqatës dhe morën një numër të konsiderueshëm nga publikimet e shoqatës, madje edhe në anglisht. Ne gjithashtu patëm rastin të kontaktonim me subjekte e shoqata që merren me trajnimin profesional të të rinjve dhe të shkëmbejmë materialet përkatëse.

SHIFRA PËR VITIN 2002

Disa statistika

Gjatë vitit 2002 janë regjistruar në zyrën tonë 156 persona, prej të cilëve 152 meshkuj dhe 4 femra. Pjesa më e madhe janë të ardhur kryesisht nga jugu i Shqipërisë, por edhe nga Shqipëria e Mesme dhe ajo e Veriut. Nga këta 120 të rinj fituan të drejtën e përfshirjes në programin tonë. 10 të rinj u ndihmuan financiarisht të kryenin kurse trajnimi në kompjuter, gjuhësh të huaja dhe patentë shoferi.

Disa rezultate

111 të rinj përfunduan me sukses trajnimin profesional 9-mujor, ndërkohë që 14 kontrata u ndërprejnë për arsye se të rinjtë migruan sërish. 84% e të rinjve të përfshirë në programin e nxënies së zanatit mbaruan me sukses dhe u punësuan ose vazhduan të ushtronin të njëjtin profesion në vende të tjera, kurse një pjesë u vetëpunësuan duke vënë kështu në jetë njohuritë e marra gjatë periudhës nëntëmuajore. 77.5% e të rinjve e konsideruan programin e nxënies së zanatit si "shumë të dobishëm" dhe 19.8% "të dobishëm". 96.4% e klientëve e vlerësuan shërbimin e zyrës si shumë të mirë dhe 3.6% të mirë.

Ndër kërkesat e tyre renditeshin ndihma financiare, gjetja e punës dhe pak prej tyre kërkonin të vazhdonin shkollën e lënë përgjysmë.

Ndërkohë në qershor të këtij viti u mbajt mbledhja e radhës së bordit të shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”. Gjatë kësaj mbledhjeje në mënyrë të veçantë u vu theksi te zgjerimi i mëtejshëm i aktivitetit të shoqatës dhe forcimi i kapacitetit organizativ si garanci për një vazhdueshmëri të suksesshme. U hodh gjithashtu ideja që ndihma duhej të jepej në dy kahje: për të rinjtë përfitues dhe biznesmenët apo trajnerët e të rinjve.

VITI 2003

Viti 2003 ishte viti i ndryshimeve dhe zhvillimeve të dukshme për Shoqatën “Shpresë për të Ardhmen”. Përveç projektit “Kape të Ardhmen” që hyri në vitin e tij të katërt, shoqata filloi punën edhe me dy projekte të reja: 1. Integrimi profesional dhe social i migrantëve të brendshëm dhe 2. Riintegrimi i të kthyerve Vullnetarisht nga Mbretëria e Bashkuar. Kjo u realizua në bazë të një marrëveshje midis shoqatës sonë dhe IOM Tirana për të bashkëpunuar në implementimin e programit VARRP, të iniciuar nga IOM Londër. Kështu në Shkurt të vitit 2003 u nënshkrua marrëveshja e parë ndërmjet Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen” dhe IOM Tirana, e cila u pasua nga një marrëveshje e re në tetor të këtij viti. Shërbimet që do të ofroheshin për këto kategori ishin shërbimet standarde që ofrohen për përfituesit e projektit “Kape të Ardhmen”. Si fillim numri i personave të referuar nga



Bordi i shoqatës

IOM ishte vetëm 9, prej të cilëve 7 u arrit të sistemoheshin në vende pune dhe të rifillonin normalisht jetën në vend pas një periudhe disavjeçare emigrimi.

Më 21 Tetor u nënshkrua marrëveshja e dytë midis IOM Tirana dhe Shpresë për të Ardhmen. Kjo marrëveshje përmban përfshirjen në programin tonë të ndihmës për riintegrim të 30 të kthyerve vullnetarisht nga Anglia.

Stafi ynë filloi menjëherë nga puna duke krijuar kontaktet e para me ta dhe duke arritur të lidhte edhe kontratat e para për punësimin e tyre. Deri në fund të muajit dhjetor 2003 ishin sistemuar më shumë se gjysma e tyre.

Shoqata u përfshi në rrjetin e OJF-ve shqiptare dhe ndërkombëtare të migrimit që operojnë në vendin tonë. Kështu një herë në muaj organizohen nga sekretariati i këtij rrjeti takime me një tematikë të caktuar ose referime nga të ftuar. Qëllimi i këtyre takimeve

është rritja e bashkëpunimit si dhe lobimi apo nxjerrja e rekomandimeve për institucionet qeveritare për çështje të ndryshme si migrimi ilegal, Kodi i Ri i familjes, dhuna ndaj gruas, trafikimi i qenieve njerëzore etj.

VIZITA

Në Prill 2003 shoqata jonë pret si vizitorë një grup tjetër zviceran. Grupi përbëhej nga 13 persona, të cilët punonin si punonjës socialë në burgje, edukatorë burgu, juristë dhe mësues. Disa prej pjesëtarëve të grupit kishin pasur kontakte të drejtpërdrejta me të rinjtë shqiptarë që vuanin dënime në burgjet e Zvicrës.

Grupi shfaqti interes të madh për t'u njohur nga afër me të rinjtë përfitues të programit tonë. Ata vizituan disa qytete të Shqipërisë si Shkodrën, Beratin, Fierin, Lezhën etj. ku panë sesi të rinjtë shqiptarë, të cilët kishin emigruar në Zvicër përpiqeshin të riintegroheshin në shoqërinë shqiptare. Vizitorët e huaj u impresionuan veçanërisht me përpjekjet, forcën e brendshme të të rinjve beratas, të cilët edhe pse kishin pak mundësi në qytetin e tyre të vogël mundoheshin t'i shfrytëzonin ato për ta ndërtuar jetën në qytetin e tyre të lindjes. Grupi vlerësoi punën e projektit "Kape të Ardhmen" duke e parë atë si një projekt mjaft të nevojshëm për të rinjtë shqiptarë të riatdhesuar. Ja disa prej përshtypjeve të tyre:

.....● **Ju lumtë për punën që bëni!**

.....● **Punë e shkëlqyer! Ju uroj sa më shumë fuqi për të ecur më tej.**

.....● **Faleminderit për ftesën!**

.....● **Jeni shumë për t'u admiruar ju që merrni pjesë në ndërtimin e diçkaje të madhe në tokën shqiptare.**

.....● **Keni gjithë kurajon time për të vazhduar më tej.**

AKTIVITE SOCIAL- KULTURORE TË ZHVILLUARA NGA SHOQATA GJATË VITIT 2003

Në kuadër të programit të riintegritimit social-kulturor që përmban programi ynë gjatë vitit 2003 janë realizuar një sërë aktivitetesh me përfituesit e këtij projekti. Përveç takimeve mujore Shtëpia e Hapur, e reja e këtij viti ishin aktivitetet e organizuara në bashkëpunim me klientët dhe stafin e projektit.

Gjatë takimeve Shtëpia e Hapur, vitin që shkoi u diskutuan një sërë temash interesante si: "Problemet gjinore në shoqërinë shqiptare", "Emigracioni", "Droga dhe pasojat e saj", "Edukimi dhe fenomeni i braktisjes së shkollave", "Si të jemi të suksesshëm në një intervistë pune", "Problemet e mjedisit" etj. Këto takime shërbejnë si një mundësi mjaft e mirë që të rinjtë përfitues dhe stafi të krijojnë

marrëdhënie më të ngushta midis tyre dhe janë konkretizim i dëshirave të shprehura shpesh nga të rinjtë çka është edhe një nga objektivat e programit të shoqatës sonë. Pikërisht në funksion të këtij qëllimi, gjatë vitit 2003 u organizuan dy ndeshje futbollit me përfituesit e projektit, ndjekja drejtpërdrejt në stadium e ndeshjes së futbollit të ekipit tonë kombëtar me përfaqësuesen e Irlandës, vajtja kolektive në kinema për të parë filmin shqiptar “Letra ere” që kishte si subjekt emigrimin dhe pasojat e tij të hidhura, vizitë në qytetin e Krujës si dhe organizimi i festës së Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri në mjediset e zyrës.

Në të ardhmen shpresojmë që të kemi më shumë aktivitete social-kulturore si edhe një rritje të pjesëmarrjes nga ana e të rinjve. Kjo duhet parë jo vetëm si një vlerësim që i bëhet iniciativave të tilla, por edhe si një rritje e nivelit të bashkëpunimit me përfituesit e programit gjë që do të çojë me siguri në përmirësimin dhe efikasitetin e shërbimeve tona.




TË RINJ TË RIATDHESUAR TË REGJISTRUAR NË ZYRË GJATË VITIT 1999-2003

Tabelë përmblledhëse

1999		2000		2001		2002		2003	
Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
2	47	11	173	25	233	4	152	8	127
		49		184		156		135	
Totali		782							

STATISTIKA GJATË 1999-2003



SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E PËRFITUESVE.

Numri i të rinjve që janë regjistruar në zyrë deri në Mars 2004 është 732 meshkuj dhe 50 femra. Personat vijnë nga e gjithë

Shqipëria. Pjesa më e madhe e tyre janë të vendosur në Tiranë, një grup tjetër i madh vjen nga Berati. Por ka gjithashtu shumë të tjerë nga Shkodra, Lezha, Puka, Tropoja, (Shqipëria e Veriut) Durrës, Elbasan (Shqipëria e Mesme), Fier, Lushnjë, Kuçovë,

Skrapar, Vlorë, Sarandë (Shqipëria e Jugut). Shumëllojshmëria e zonave nga të cilat vijne është lehtësisht e dallueshme, sepse të gjithë bartin në vetvete karakteristikat specifike të zonës. Por, megjithë veçantitë e

zonës, të gjithë kanë pak a shumë të njëjtat probleme që has e gjithë shoqëria shqiptare pas tranzicionit si papunësia, varfëria, mungesa e strehimit etj.

D O N A T O R E T

PROJEKTI “KAPE TË ARDHMEN” LINDI SI INICIATIVË E Z. PATRICE DE MESTRAL, I CILI BËRI EDHE MBLEDHJEN E FONDEVE NË DONATORË PRIVATË ZVICERANË NGA 1999 DERI NË FUND TË VITIT 2000.

Një kontribut ka dhënë edhe **HEKS**.

Gjatë viteve 2001-2002 shoqata u mbështet nga **SDC (Agjencia Zvicerane e Kooperimit dhe Zhvillimit)** në Bernë dhe **HEKS (Ndihma e Ndërkishës Zvicerane)**.

Në 2003 një donator i ri pranoi ta mbështeste për dy vjet shoqatën tonë: **EED (Ndihma për Zhvillim e Kishës Evangjeliste Gjermane)** dhe në vazhdimësi **HEKS**.

Shoqata është financuar gjithashtu nga **IOM** për atë pjesë të përbashkët të programit që përmban marrëveshja dypalëshe.

Në 2003 disa donatorë privatë zviceranë, të cilët i kanë njohur arritjet tona në ndihmë të të riatdhesuarve, kanë pasur dashamirësinë të japin kontributin e tyre.

Marrëdhëniet me donatorët ne i kemi konsideruar shumë të mira. Ato janë ngritur mbi baza partneriteti të barabartë dhe të sinqertë, çka i ka shërbyer ecjes përpara të aktiviteteve tona dhe mbarëvajtjes së shoqatës.

Ne shprehim mirënjohjen tonë dhe i falenderojmë thellësisht, duke besuar plotësisht se pa kontributin e tyre nuk mund të bëhej i mundur realizimi i programit tonë dhe të prekej suksesi.



Irena Dono dhe Madeleine Hirsch, përfaqësuese e HEKS

PLANE PËR TË ARDHMEN

“Shpresë për të Ardhmen” është një shoqatë, e cila me projektet e saj do të vazhdojë t’u ofrojë përkrahje dhe mbështetje financiare, psikologjike dhe morale të rinjve tashmë të kthyer jo vetëm nga Zvicra, por edhe nga vende të tjera të Evropës Perëndimore në mënyrë që ata të riintegrohen në shoqërinë shqiptare. Po kështu do të vazhdohen të ndihmohen edhe migrantët e brendshëm, integrimi i të cilëve është po aq i vështirë sa edhe ai i të riatdhesuarve.

Një pjesë e programit tonë do të fokusohet

te gratë migrante të brendshme që janë nga grupet më në nevojë.

Që të realizohen synimet tona kërkohet më shumë bashkëpunim me organizata të tjera dhe përfshirje në rrjetet e organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare që merren me problemet e migrimit si edhe një mirëkuptim nga donatorët që shpresojmë të mbështesin projektet tona.

Ne jemi të gatshëm për drejtime dhe ndryshime të reja, të cilat padyshim do t’i jepnin projekteve tona më shumë tonalitet dhe rezultate më të frytshme.



Logo e Shoqatës e punuar në dru nga përfituesi i projektit Hektor Kurti

Materiali u përgatit në bazë të materialit faktik që gjendet në zyrën e shoqatës nga:
AURORA ELEZI & BRUNILDA QEVANI

Ky është një skicim në vija të përgjithshme i ecurisë së shoqatës sonë që mendojmë ta rristrukojmë, ta pasurojmë me fakte, të dhëna dhe shifra që do të përbëjnë materialin e një broshure të veçantë

TË RINJTË SHQIPTARË KAPIN TË ARDHMEN

Një projekt i vogël në Shqipëri jep një ngacmim drite në mes të errësirës dhe pëshqjellimit që rrethon çështjen e azilantëve dhe emigracionit në Evropë.

Qytetet e Evropës Perëndimore janë plot me të rinj shqiptarë, të cilët kanë lënë një nga shtetet më të varfra të kontinentit në kërkim të një jete më të mirë. Shumë prej tyre punojnë ilegalisht, disa të tjerë përfshihen në rrjetin e drogës apo të krimit. Nga një vëzhgim i kohëve të fundit në Shqipëri i 260 personave përkatësisht 15 deri 18 vjeç rezultoi se 46.5% e tyre do të emigronin me mundësinë më të parë.

Që nga viti 1998 qeveria zvicerane ka riatdhesuar 4900 shqiptarë. “Pas këtyre shifrave fshihen njerëz ëndrrat e të cilëve nuk mundën të realizoheshin”, thotë Patrice de Mestral, kordinatori zviceran i projektit “Kape të Ardhmen”, i cili u ka ofruar 412 të riatdhesuarve shansin për të filluar nga e para.

Projekti merr përsipër të mbulojë 60% të pagesës kur një punëdhënës pranon t’i ofrojë 9 muaj formim profesional një të riu të riatdhesuar. 80% e përfituesve të programit kanë vazhduar të punojnë edhe më pas. Skema e cila është aktive në 17 rrethe gjithashtu kontribuon në zhvillimin e

zonave rurale dhe kështu frenon ikjen nga zonat rurale për të jetuar në barraka në kryeqytetin Tiranë.

De Mestral ka 17 vjet eksperiencë si kapelan burgu në kantonin e Zurihut, gjithashtu ka mbajtur edhe postin e kapelanit të policisë së qytetit. Kur doli në pension ai nuk mund të rreshte së menduari për të rinjtë shqiptarë që kishte takuar në burg – disa që prisnin të dëboheshin nga Zvicra pas hyrjes ilegale apo që u ishte mohuar e drejta për azil, të tjerë që vuanin dënimin për trafikim droge. “Kur i takova këta të rinj, çështjet e tyre ishin mbyllur dhe ata ishin duke u kthyer në shtëpi” thotë ai. “Gjithçka që mund t’u thosha ishte: “Një ditë unë do t’ju takoj në vendin tuaj”.

Pak muaj pasi doli në pension de Mestral e mbajti premtimin. Ai u mbështet te një shoqatë grash në Tiranë, e lidhur me HEKS (Ndihma e Ndërkishës Zviceriane). Në Dhjetor 1998 ai financoi një vëzhgim mbi të gjithë shqiptarët që ktheheshin nëpërmjet aeroportit nga Zvicra. Vetëm 25% deklaruan se kishin ndërmend të qëndronin në Shqipëri.

Kape të Ardhmen u krijua në fillim të vitit 1999 nën drejtimin e Irena Donos, ndërsa de Mestral shpërndante fletëpalosje në burgjet zviceriane duke i ftuar shqiptarët

të kërkonin mbështetje pranë zyrës së projektit në Tiranë për të rindërtuar jetën e tyre pasi të riktheheshin në Shqipëri.

Shpërthimi i luftës në Kosovë në Mars 1999 ndaloi gjithçka në vend. “Për katër muaj ishte shumë vështirë që dikush të vizitonte zyrën tonë”, thotë de Mestral. “Njerëzit kishin frikë se mos ne bashkëpunonim me policinë sekrete shqiptare. Në Gusht 1999 ishim pothuajse gati të hiqnim dorë”. Por stafi i projektit shpërndau fletëpalosje në kafenetë e Tiranës për të larguar frikën e njerëzve. Klienti i parë erdhi në zyrë dhe, në fund të 1999, ishin lidhur 20 kontratat e para.

Projekti fokusohet në një target grup të vogël – tek të kthyerit nga Zvicra dhe familjet që prisnin prej tyre t’u sillnin ca para. Shumë familje të zonave rurale mbledhin me të keq një dorë para për të çuar në Evropë një të ri të familjes me shpresën se ai do të bëjë dhe do të dërgojë para në familje. “Kur kthehen duarbosh, kjo shihet si dështim”, thotë de Mestral. «Projekti i ndihmon ata të mos e shohin veten të humbur».

Ata që përzgjidhen si përfitues në projekt u kërkohet të gjejnë një sipërmarrës, i cili i pranon ata si nxënës për të mësuar një zanat. Në shoqërinë e mbyllur shqiptare, këta pronarë të vegjël shpesh mbajnë në punë anëtarë të familjes. Në këtë rast ata përfitojnë subvencionim për vendin e punës që ofrojnë, ndërsa përfituesit e projektit

fitojnë një zanat.

Jeta e biznesit në Shqipëri është e vështirë, është e lidhur me korrupsionin dhe krimin e organizuar. Mungesa e lehtësirave bankare dhe postale do të thotë shpërndarje në dorë e kompensimit të pagës çdo muaj. Vizitat mujore në vendet e punës sigurojnë mbështetje për të dyja palët, punëdhënësin dhe nxënësin. Gjithashtu projekti organizon takime ku pjesëmarrësit mund të diskutojnë problemet e tyre.

Në fillim fondet u siguruan nga HEKS dhe nga abacitë katolike dhe protestante si edhe nga “Bregu i Artë” i Liqenit të Zuriut. Më pas kanë kontribuar departamenti zviceran për ndihmë teknike dhe besim humanitar, policia zvicerane, Agjensia e Zhvillimit të Kishave Evangjeliste në Gjermani (EED) dhe kohët e fundit Organizata Ndërkombëtare për Emigracionin. Si rrjedhojë projekti është i hapur për shqiptarët e riatdhesuar jo vetëm nga Zvicra.

Shoqata “Shpresë për të Ardhmën”, prindi i projektit “Kape të Ardhmen”, punon gjithashtu për rritjen e ndërgjegjësimit në shkollat e mesme mbi problemet që përballen emigrantët. Sikurse tregon vëzhgimi i tyre, një pjesë e madhe e të rinjve shqiptarë dëshirojnë të largohen nga Shqipëria për shkak të problemeve ekonomike. “Nuk kisha para, rroba si shokët e mi, në shtëpi jetonim shumë keq, nuk kishim as bukë të hanim” shkruan një

migrant i kthyer në buletin e shoqatës. “Ata ndjekin Televizionin Italian dhe Amerikan dhe mendojnë “Përse rri akoma këtu” thotë de Mestral.

Kur e takova, ai ishte duke shkuar në Shqipëri për të njëzetën herë. Suksesi i projektit i kishte dhënë mundësinë dhe i kishin sugjeruar që ta hapte edhe në vende

të tjera, por de Mestral 70 vjeçar mendon ta dorëzojë atë te dikush tjetër. “E kam të qartë se ajo që po bëj unë është si të hedhësh disa pika uji në një gur të nxehtë”, thotë ai. “Por, siç ka thënë Nënë Tereza: **“Edhe oqeani është i përbërë nga pika uji”**. Dhe për 412 të rinjtë, përfitues të projektit, kjo është më shumë se sa një gjest simbolik.

Mary Lean

Shënim: Artikull i botuar në revistën “Për një ndryshim”



AKTIVITETI I SHOQATËS “SHPRESË PËR TË ARDHMEN”

